

RAPORTI I THELLUAR
I VLERESIMIT
TE
NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETT:

**“TRANSPORTI I MATERIALEVE TE LENGHME DHE TE NGURTA, I NAFTES BRUTO DHE
NENPRODUKTEVE TE SAJ, I UJERAVE TE NDOTURA DHE UJERAVE TE ZEZA, I
MBETJEVE TE NGURTA, PLASTIKE E MBETJE URBANE SI DHE TRAJTIMI DHE
RICIKLIMI I UJERAVE TE NDOTURA, UJERAVE TE ZEZA, MBETJEVE TE NGURTA
URBANE, MBETJEVE PLASTIKE, MBETJEVE TE NDOTURA NGA HIDROKARBURET
DHE NAFTES BRUTO”**

Subjekti: FABAS sh.p.k





Vendndodhja: Fier

Pergatiti materialin : “Eko – Studio - Projekt” sh.p.k

Tirane 2015



PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
NEGATIVE NE MJEDIS**

5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

+ HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Transporti i materialeve te lengshme dhe te ngurta,i naftes bruto dhe nenprodukteve te saj, i ujerave te ndotura dhe ujerave te zeza, i mbetjeve te ngurta, plastike e mbetje urbane si dhe trajtimi dhe riciklimi i ujerave te ndotura,ujerave te zeza, mbetjeve te ngurta urbane, mbetjeve plastike, mbetjeve te ndotura nga hidrokarburet dhe naftes bruto”.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

“Transporti i materialeve te lengshme dhe te ngurta,i naftes bruto dhe nenprodukteve te saj, i ujerave te ndotura dhe ujerave te zeza, i mbetjeve te ngurta, plastike e mbetje urbane si dhe trajtimi dhe riciklimi i ujerave te ndotura,ujerave te zeza, mbetjeve te ngurta urbane, mbetjeve plastike, mbetjeve te ndotura nga hidrokarburet dhe naftes bruto “.

Kjo eshte arritur duke:

- Dhene gjendjen reale nga pikepamja e ndikimit te ketij aktiviteti ne mjedisin human.
- Analizuar faktoret pozitive dhe negative mjedisor.
- Dhene rekomandimet per masat zbutese dhe minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligji nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ PROFILI I PROPOZUESIT

Subjekti "FABAS" sh.p.k me administrator Z. Fatos Sinaj do te ushtroje aktivitetin **"Transporti i materialeve te lengshme dhe te ngurta,i naftes bruto dhe nenprodukteve te saj, i ujerave te ndotura dhe ujerave te zeza, i mbetjeve te ngurta, plastike e mbetje urbane si dhe trajtimi dhe riciklimi i ujerave te ndotura,ujerave te zeza, mbetjeve te ngurta urbane, mbetjeve plastike, mbetjeve te ndotura nga hidrokarburet dhe naftes bruto"**. Aktiviteti zhvillohet ne Rruga Kastriot Muca, Lagjia "29 Nentori", Rajoni 3, Bashkia Fier.

Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Deklarate Mjedisore sipas Ligjit Nr. 10440 Nr.7.7.2011 **"Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"** dhe Vendim Nr.13, date 04.01.2013 **" Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis"**.

a. Pershkrimi i qellimit te propozuar

Projekti i paraqitur nga Shoqeria **"FABAS" sh.p.k** ka per qellim menaxhimin e mbetjeve duke patur parasysh mbrojtjen e shendetit dhe te mjedisit. Aktiviteti merr ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjell deme mjedisit vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren ose faunen
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat ose ererat
- Pa demtuar peisazhin

Nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit.

b. Pershkrimi i proceseve teknologjike, kapaciteti prodhues, lendet e para, produktet perfundimtare.

Origjina e mbetjeve urbane: Disa kategori të mbetjeve urbane janë plehrat shtëpiake, mbetjet e tregtisë, të shitjeve, mbetjet institucionale, mbetjet nga ndërtimet, mbetjet nga mirëmbajtje rrugësh, mbetjet e kanaleve dhe mbetjet sanitare. Mbetjet inerte nga bujqësia dhe aktivitetet e minierave nuk konsiderohen si mbetje urbane, meqenëse ato janë krijuar jashtë zonës së banimit.

✚ MBETJE URBANE

- Mbetjet shtëpiake

Janë mbetjet që rezultojnë nga aktivitetet shtëpiake, si psh nga përgatitjet e ushqimit, pastrim, djegiet, kopshtet, larja e rrobave, riparimet në shtëpi, hedhja e ambalazheve, letrave, gazetave etj.

- Mbetje nga tregtia

Janë mbetje e prodhuara nga hapësirat e magazinimit, tregjet, restorantet, hotelet dhe dyqanet. Kontribuesi kryesorë në përbërjen e mbetjeve nga tregtia janë materialet e paketuara për produkte ushqimore. Në Tirane dyqanet publike krijojnë pjesën më të madhe të mbetjeve nga tregtia.

- Mbetjet nga institucionet

Janë mbetjet e gjeneruara nga shkollat, zyrat e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, njësitë ushtarake, bankat dhe institucionet fetare. Mbetjet e letrave përfshijnë sasinë më të madhe të kësaj kategorie që pasohet nga mbetjet e ushqimit. Mbetjet nga institucionet depozitohen në kosha plehrash të vendosura pranë tyre.

- Mbetjet nga mirëmbajtja e rrugëve

Mbetjet nga mirëmbajtja e rrugëve përfshijnë plehrat, pluhurin dhe dherat. Ato kanë gjithashtu potencialin të mbajnë sasi domethënëse të mbetjeve shtëpiake.

PLASTIKA

Projekti do te kryeje sherbime ne fushen e grumbullimit te lendes plastike per riciklim. Lenda plastike e cila eshte edhe lenda e pare mblidhet nga pika grumbullimi te ndryshme dhe pasi riciklohet shitet ne pika te ndryshme private qe prodhojne qese dhe tubo plastike.

Materiali perpara se te futet ne procese si dhe ne cdo dalje te tij gjate ciklit te perpunimit pas cdo procesi kalon nen efektin e ujit dhe te fitrave perkates.

SKRAPI

Fazat e grumbullimit dhe riciklimit te skrapit jane:

- a. Magazinimi i skrapit
- b. Peshimi i skrapit (metaleve ferore dhe jo ferore)
- c. Seleksionimi
- d. Copetimi, presimi
- e. Transporti drejt subjekteve tregtare.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

• Gjeologjia e rajonit

Ne kete rajon kemi te bejme me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfera me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrrjedhje te ujerave te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuaternar Q₄AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.

- **Klima**

Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë ne brezin e klimes mesdhetare, dhe dallohet për tipare me te shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehte dhe e thate me shkelqim të madh te diellit dhe dimeri i bute dhe me rreshje te mëdha. Ngricat dhe debora janë dukuri tepër te rralla. I nxehti fillon qysh nga mesi i pranveres dhe vazhdon deri në fund te tetorit. Klima e Fierit është e ngrohte sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej ererave te ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë te ditëve me diell mesatarisht 2800 ore ne vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë te cregullt ato janë perqendruar kryesisht ne gjysmen e ftohte te vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000mm/vit. Vera ne Fier është e thate dhe shpesh nuk bie shi për jave te tera. Muajt me te lagesht janë nentori dhe janari, kurse muajt me te thate korriku dhe gushti. Ererat fryjne ne drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje te mëdha, ndërsa gjatë veres era fryn nga veriu dhe veriperendimi. Afersia me detin bën qe klima te jetë e bute dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat te bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 15 grade C-16 grade C.

- **Trashegimia arkitektonike**

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte te trasheguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonamente.

- **Relievi**

Rrethi i Fierit ofron dhe potenciale te rëndësishme natyrore për zhvillimin e tij. Ne përgjithësi kemi te bëjmë me një rajon fushor me lartesi nga 0-100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shumë pjellore. Edhe relievet kodrinore janë pergjithesisht te buta dhe te mundshme për shfrytezim bujqesor. Ne zonat e rrafsheta zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje te veçanta tokash si aluvionale qe takohen ne luginat e Semanit e Vjoses, tokat e kripura qe shtrihen ne Hoxhare si dhe tokat mocalishte te Roskovecit.

Ne rrethin e Fierit shtrihet një pjesë e Myzeqese se Madhe, Myzeqeja e Vogel dhe fushat e Frakulles e te Cakranit.

- **Hidrografia**

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi te veçantë kanë pasurite ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi pershkohet nga lumenjte Seman, Vjose e Gjanica. Semani -281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin ne afersi te Beratit.Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin ne 96 m³/sek.Semani është nder lumenjte me eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjose - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit ne Greqi.Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 6700 km²,ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Pocemit e te Kalivacit.Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 234 km².Është një nga lumenjte me te ndotur në vend, për shkak te derdhjes se naftes. Rrethi ka dhe disa liqene artificiale ku me i madhi e me i rendesishmi prej tyre është ai i Kurjanit me siperfaqe 375 ha, ujerat e tij përdoren për ujitje.

- **Flora dhe fauna**

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë rrethi i Fierit dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi i Fierit bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati i makies,ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE

○ **Ndikimet ne popullsi**

Realizimi i aktivitetit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit ku do zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsisë se rajonit.

○ **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

○ **Ndikimet nga zhurmat**

Ricklimi i plastikes është proces i cili emeton zhurma të matshme, dhe brenda normave te lejuara duke perfshire zhurmat e makinerive gjate copetimit mekanik te materialit plastik qe do te riciklohet. Mjetet e transportit janë të kolauduara periodikisht, ndërsa për makineritë e paisjet niveli i zhurmave është brenda normativave te lejuara.

○ **Ndikimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit qe zhvillohet nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere. Edhe makinat e transportit do te kontrollohen vazhdimisht per kushtet teknike te tyre ne mneyre qe te mos kete clirim gazesh jashte normave nga djegia e karburantit.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Me qellim qe te parandalohen , shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marr masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

❖ **Grumbullimi ujerave**

Gjate procesit te punes nuk do kemi perdorim masiv e ujit i cili perdoret per te ftohur makinerite dhe plastiken nepermjet nje cikli te mbyllur (riciklohet nga makineria nepermjet nje pompe. Kjo sasi uji riperdoret disa here dhe nuk permban elemente

kontaminues ne perberjen e tij. Ne pergjithesi materialet skrap metalik te grumbulluara do te vijne te pastra nga ana kimike dhe jane te gatshme per tu shitur me shumice. Vetem do te kryhet procesi i perpunimit (seleksionik mekanik, presim, copetim, paketim).

❖ **Zhurmat**

Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe do punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej fabrikes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth por as per punonjesit brenda fabrikes, sepse eshte brenda normave te lejuara per mjedise pune.

Megjithate aktiviteti ka marre masat perkatese:

- Kompresoret duhet te pershtaten sipas modeleve perkatese me kapaket e radhitur dhe te mbyllur mire te cilet do te mbahen mbyllur per sa kohe qe makinerite jane ne pune dhe te gjitha mjetet e tjera shtese pneumatike qe do te pershtaten me silenciatoret perkates.
- Makinerite qe do te perdoren do te mbyllen here pas here ne kohën kur nuk do te nevojiten per shfrytezim.
- Cdo lloj impianti, sic jane gjeneratoret apo pompat/motoret qe jane te nevojshme per nderhyrje dhe pas oreve te ligjshme te punes do te mbeshtillen me nje pjese akustike apo ekran te levizshem per te minimizuar ndotjen akustike te mjedisit perreth.

❖ **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do i pajis me uniforma dhe mjete mbrojtese.

❖ **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne perfundimisht ne perftimin e pamjeve te parashikuara ne projekt, me siperfaqe te pastra, te sistemuara e te gjelberuara.

5. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

❖ Konkluzione

- ✓ Zbatimi i projektit do të kontribuojë në rritjen ekonomike në nivel lokal dhe kombëtar si dhe rritjen e mundësive për vende të reja pune.
- ✓ Projekti nuk ka shkarkime mbi normat në mjedis dhe indirekt ndihmon në pakesimin e mbeturinave plastike të cilat pas riciklimit në subjekte të tjera shërbejnë si lende e pare për fabriken
- ✓ Zbatimi me korrektesi i teknologjisë lejon që shkarkimet në atmosfere të mbeten brenda normave të përcaktuara për këto lloje industri
- ✓ Procesi teknologjik nuk shoqërohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Gjate procesit të punës do kemi përdorim masiv të ujit vetëm për të ftohur makineritë dhe plastikën nuk ka përdorim tjetër të tij. Kjo sasi uji ripërdoret disa herë dhe nuk përmban elemente kontaminues në përzierjen e tij
- ✓ Niveli i zhurmave në fabrike është në parametra normale dhe në nivele të pranueshme sepse pajisjet që punojnë duke llogaritur sipërfaqen e hapur nuk kryejnë ndotje akustike.

❖ Rekomandime

- Të merren masa dhe të kryhet reabilitimi i mjedisit në rastet e ndonjë aksidenti.
- Të kryhet rregullisht kontrolli gjendjes teknike të pajisjeve dhe mjeteve të transportit.
- Të kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese në territor.
- Të njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- Të largohen të gjitha mbetjet ngurta që krijohen si rezultat i aktivitetit njëzëz në vendet e përcaktuara nga pushteti lokal.
- Të kontrollohen në mënyrë periodike proceset nëpër të cilat kalon riciklimi i skrapit, plastikës, sfungjerit dhe mbetjeve urbane.